

Shërbimi
Sëmundesh
Planari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. 3365 Prot.

Tiranë, më 04.12.2025

Lënda: Paraqitje e relacionit të përmirësuar shoqërues për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”

**ZOTIT NIKO PELESHI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

KËTU

I nderuar zoti Kryetar,

Në cilësinë e deputetit nismëtar të projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (“Projektligji”), të depozituar në Kuvend më datë 10/11/2025, në përputhje me nenin 69 të Rregullores së Kuvendit, ju paraqes bashkëlidhur versionin e përmirësuar të relacionit shoqërues, i cili zëvendëson relacionin paraprak të dorëzuar fillimisht me projektligjin.

Relacioni i rishikuar është hartuar në përputhje të plotë me përmbajtjen e dispozitave të projektligjit të depozituar dhe synon të sigurojë një trajtim më të qartë, koherent dhe të argumentuar të qëllimeve dhe ndryshimeve të propozuara, duke reflektuar gjithashtu komentet e marra gjatë fazës së konsultimit të projektligjit.

Ju lutem, të vijohet me procedurat për përfshirjen e këtij relacioni në dokumentacionin shoqërues të projektligjit dhe shpërndarjen e tij pranë komisioneve parlamentare përkatëse.

Bashkëlidhur gjeni Relacionin e përmirësuar shoqërues të Projektligjit.

Me respekt,

Olsi Komici

Deputeti Propozues



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

**RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE
DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka objekt përcaktimin e statusit të magjistratëve, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet, mënyrën e pranimit dhe emërimit në sistem, evoluimin profesional deri në përfundimin e mandatit të magjistratit, mënyrën se si vlerësohet profesionalisht, si edhe përgjegjësinë disiplinore penale e civile të tyre.

Ky ligj garanton pavarësinë, paanësinë dhe llogaridhënien e magjistratëve me qëllim ndërtimin e një sistemi drejtësie të pavarur, të paanshëm, të përgjegjshëm, të drejtë, profesional, të besueshëm dhe të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarit.

Ky projektligj është hartuar në konsiderim të rekomandimeve të Komisionit Evropian, me synim përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga procesi i integritetit evropian, veçanërisht në fushën e shtetit të së drejtës (Rule of Law), duke u mbështetur në rekomandimet e raporteve të Komisionit Evropian për Shqipërinë për periudhën 2021–2025, të cilat theksojnë nevojën për përmirësim të kuadrit ligjor si dhe të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës për Shqipërinë, i cili kërkon forcimin e reformës në drejtësi dhe ndërtimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, funksional dhe efektiv, përmes rritjes së llogaridhënies së institucioneve të qeverisjes së drejtësisë, depolitizimit të vendimmarrjes, përzgjedhjes mbi bazë meritokracie, si dhe ngritjes së mekanizmave të besueshëm për kontrollin e integritetit dhe pasurisë.

Në këtë kuptim, projektligji përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përmbushjes së kushteve të negociatave për Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore, i cili është ndër kapitujt themelore dhe më të ndjeshëm të *acquis communautaire* të BE-së.

Nisma që kam sjellë në Kuvend, nuk përfaqëson thjesht një ndërhyrje teknike në një ligj ekzistues, por reflekton një fazë të dytë të konsolidimit të reformës në drejtësi, duke i dhënë zbatim konkret angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në kuadër të integritetit në BE dhe duke adresuar problematikat e identifikuara gjatë viteve të para të zbatimit të ligjit nr. 96/2016. Këto ndërhyrje shënojnë një kalim nga reforma legjislativë drejt reformës institucionale funksionale, ku parimet e transparencës, meritokracisë dhe llogaridhënies marrin një formë të qartë nëpërmjet dispozitave konkrete dhe mekanizmave zbatues.

Objektivat që synohen të arrihen me këtë projektligj janë:

- ✓ Zbatimi i piketave të ndërmjetme (*interim benchmarks*) të Komisionit Evropian;
- ✓ Adresimi i sfidave që lidhen me mungesat e krijuara në sistem në drejtimin e gjykatave/zyrave të prokurorisë (*ku pothuajse të gjitha gjykatat/zyra të prokurorive drejtohen nga zëvendëskryetar*), duke parashikuar një skemë kalimtare që i përgjigjet realitetit dhe zhvillimeve në sistem si dhe në funksion të zbatimit të hartës së re gjyqësore;
- ✓ Përmirësimin e kuadrit ligjor në lidhje me funksionalitetin e ILD me qëllim përmbushjen e kompetencave kushtetuese dhe ligjore;
- ✓ Rritjen e transparencës së Këshillave në lidhje me publikimin e vendimeve për statusin e magjistratëve dhe nëpunësve civil gjyqësor, nëpërmjet aplikimit të standardeve të harmonizuara me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa më sipër, rezulton e domosdoshme ndërhyrja legjislativë në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përmes këtij projektligji.

2. VLERËSIMI I KUSHTETUTSHMËRISË, LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMIT ME LEGJISLACIONIN KOMBËTAR E NDËRKOMBËTAR

Projektligji që propozon ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e magjistratit” mbështetet në nenin 81 pika 1 dhe 2 shkronja “a” dhe nenin 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të cilat përcaktojnë qartë se:

“Ligjet që prekin organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese [...] miratohen me shumicë të cilësuar të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.”

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për të cilat parashikohen ndryshimet ligjore përkatëse, janë të përmendura shprehimisht në Kushtetutë, në nenet 147 dhe 149/a, si institucione kushtetuese të sistemit të drejtësisë. Për rrjedhojë, çdo ndërhyrje që prek mënyrën e formimit, përbërjes, kompetencave ose procedurave të funksionimit të tyre, duhet domosdoshmërisht të kalojë përmes një procedure të posaçme të miratimit me shumicë të cilësuar.

Nga pikëpamja e përmbajtjes, projektligji respekton dispozitat e Kushtetutës dhe parimet themelore kushtetuese që garantojnë: pavarësinë e gjyqësorit, gjykim të drejtë dhe të paanshëm;

parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit reciprok, si dhe parimin e llogaridhënies së institucioneve publike, efektivitetit, paanësisë dhe pavarësisë.

3. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian, për këtë arsye, nuk është i aplikueshëm vlerësimi i shkallës së përafrimit me legjislacionin e BE-së. Projektligji ka karakter tërësisht të brendshëm normativ dhe lidhet me organizimin institucional dhe procedurat e funksionimit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

4. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Projektligji përfaqëson një ndërhyrje në kuadrin ligjor të reformës në drejtësi, e cila synon konsolidimin institucional dhe rritjen e integritetit të organeve të vetëqeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Në thelb, projektligji përpiket të adresojë një sërë problematikash të vërejtura gjatë fazës së zbatimit të ligjit aktual dhe të krijojë kushte më të qëndrueshme për përzgjedhjen, verifikimin dhe funksionimin efektiv të procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve magjistratë. Argumentimi i tij mbështetet në tri shtylla kryesore: **përparësitë që sjell, problematikat që synon të zgjidhë, dhe efektet që pritet të prodhojë.**

Kjo nismë propozon të sjellë disa përparësi substanciale që lidhen me rritjen e standardeve të integritetit pasi përfshirja e dispozitave që parashikojnë kontrollin e pasurisë, figurës dhe interesave private të kandidatëve krijon një filtër efektiv për garantimin e pastërtisë së figurës së kandidatëve për magjistratë para fillimit të studimeve dhe pas diplomimit të tyre, në momentin e emërimit.

Në projektligj janë parashikuar dispozita që parashikojnë respektimin e parimit të transparencës në vendimmarrjen e këshillave, duke respektuar në të njëjtën kohë të dhënat personale përgjatë publikimit të vendimeve. Këto propozime adresojnë problematika të ngritura si nga ana e Këshillave ashtu edhe nga shoqëria civile, për të bërë vendimmarrjen e këshillave më të kuptueshme duke shmangur anonimizimin e pakuptimtë dhe sigurisht për të unifikuar praktikën në të dy këshillat.

Në projektligj adresohet një problematikë që është konstatuar lidhur me mungesën e përzgjedhjes së kryetarëve të gjykatave dhe drejtuesve të prokurorisë duke parashikuar në këtë proces dhe rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në vlerësimin e punës së drejtuesve aktualë, si dhe në vendimmarrjen përfundimtare të Këshillit për emërimin e tyre. Përfshirja e Prokurorit të Përgjithshëm në formën e dhënies së opinionit, për vlerësim të mëtejshëm nga Këshilli, së bashku me kriteret e tjera ligjore, është në përputhje me kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore në mbarëvajtjen e punës organizative dhe administrative në prokurori. Duke parashikuar ndalimin për kandidim të magjistratëve që kanë masë disiplinore në fuqi, rrit besueshmërinë dhe është në përputhje me parimet e meritokracisë në ngritjen në detyrë, si kryetar gjykate apo drejtues prokurorie.

Projektligji parashkon një mekanizëm të përkohshëm lidhur me drejtuesit aktualë të gjykatave dhe prokurorive nëpërmjet vazhdimësisë së tyre në këtë detyrë deri në vitin 2028, deri në tejkalimin e situatës së bllokimit të emërimeve të reja në këto funksione, duke vendosur padyshim kritere të vlerësueshme në çdo rast rikonfirmimi.

Projektligji, duke zgjatur afatin e komandimit për magjstratët e komanduar në Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë dhe duke parashikuar të drejtën e tyre për të vazhduar të qëndrojnë të komanduar për një periudhë më të gjatë, maksimalisht 15 vjet, përbën një mekanizëm për të shtuar aplikimet në këtë funksion dhe për të siguruar mirëfunksionimin e këtij institucioni.

Në tërësi, projektligji është koherent me frymën e reformës kushtetuese të vitit 2016 dhe i përgjigjet nevojës për konsolidim të mekanizmave të vetëqeverisjes gjyqësore, të cilat duhet të mbështeten në parime të meritokracisë, transparencës dhe llogaridhënies.

Disa nga çështjet që adreson projektligji, është të korrigjojë problematikat e vërejtura gjatë zbatimit të ligjit bazë nr. 96/2016, të cilat janë identifikuar edhe në analizat e Komisionit të Ligjeve dhe dokumentet strategjike të reformës në drejtësi.

Megjithatë projektligji nuk përfshin dispozita të përafrimit formal me *acquis* të BE-së, efektet e tij ndikojnë pozitivisht në avancimin e shtyllës së sundimit të ligjit, si pjesë e Kapitullit 23. Kjo ka një rëndësi të veçantë në vlerësimin politik të ecjes së Shqipërisë në kuadër të negociatave për anëtarësim.

5. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Projektligji përbëhet nga 13 dispozita, përmbajtja e të cilave sqarohet si vijon:

Në nenin 1 parashikohen ndryshimet e nenit 2 të ligjit, ku propozohet të shtohen përkufizimet për termat *“Pasuri”*, *“Person i lidhur”*, *“Persona të tjerë të lidhur”*, *“Person i përfshirë në krimin e organizuar”* dhe *“Të ardhura të ligjshme”*, të cilat janë të ndërlidhura me trupëzimin e normave dhe praktikave të mira të procesit të rivlerësimit kalimtar (*‘vettingut’*) të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas kërkesave për përmbushjen e piketave të ndërmjetme. Përcaktimi në mënyrë të qartë i termave është premisë për kryerjen e procesit të verifikimit në mënyrë të plotë dhe të saktë.

Në nënin 2 të projektligjit parashikohen ndryshimet në nenin 32 të ligjit 96/2016, Verifikimi i pasurisë dhe figurës, të cilat synojnë implementimin e normave dhe praktikave të mira të procesit të rivlerësimit kalimtar (*‘vettingut’*) të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke sjellë qartësimin e procedurave, sipas kërkesave për përmbushjen e piketave të ndërmjetme. Këto procedura kanë për qëllim të parashikojnë në mënyrë të qartë organet kompetente në procesin e rivlerësimit të pasurisë dhe figurës, kompetencat konkrete të tyre si dhe afatet procedurale me qëllim rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Në neni 3 të projektligjit parashikohet shtesë në shkronjën c të pikës 1 të nenit 35, “*Emërimi i kandidatit magjistrat të emëruar*”, i cili ka për qëllim të saktësojë periudhën kohore të verifikimit, për procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës para emërimit të magjistratit të diplomuar, duke parashikuar se kjo periudhë fillon nga data e kryerjes së procesit të fundit të verifikimit. Ky ndryshim ka për qëllim rritjen e efikasitetit në procesin e verifikimit të magjistratëve të diplomuar para emërimit të tyre në detyrë.

Në nenin 4 të projektligjit është parashikuar shtesë në neni 43 të Ligjit 96/2016, “*Procedura e lëvizjes paralele*”, konkretisht pika 11/1, në përmbushje të piketave të ndërmjetme dhe komenteve të KE, me qëllim për të siguruar transparencë lidhur me proceset e lëvizjeve paralele, nga ana e KLGj dhe KLP-së. Ky nen i projektaktit parashikon detyrimin për publikim nga ana e organeve të vendimeve të lëvizjes paralele por nga ana tjetër parashikon garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në nenin 5 të projektligjit është parashikuar shtesë në nenin 47 të ligjit 96/2016 të ndryshuar, “*Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë*”, konkretisht pika 7, e cila është në përmbushje të piketave të ndërmjetme dhe komenteve të KE, me qëllim për të siguruar transparencë lidhur me vendimmarrjen për ngritje në detyrë, nga ana e KLGj dhe KLP-së. Ky nen i projektaktit parashikon detyrimin për publikim nga ana e organeve të vendimeve të ngritjes në detyrë, por nga ana tjetër parashikon garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në nenin 6 të projektligjit parashikohen ndryshimet në nenin 52, “*Emërimi i kryetarëve të tjerë*”, të cilat synojnë të adresojnë disa shqetësime të ngritura nga Këshillat dhe Prokurori i Përgjithshëm. Kështu ndryshimet në pikën 4, ku pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “*Në rastin e përzgjedhjes së kryetarit të prokurorisë konsiderohet edhe opinioni i Prokurorit të Përgjithshëm për kandidatin*”, synojnë të përfshijnë Prokurorin e Përgjithshëm në procesin e rizgjedhjes së kryetarit të zyrës së prokurorisë. Përfshirja e këtij, në formën e dhënies së një opinioni, për vlerësim të mëtijshëm nga KLP së bashku me kriteret e tjera ligjore, i shërben ushtrimit të kompetencave të tij në mbarëvajtjen e punës organizative dhe administrative në prokurori si dhe në drejtim të vlerësimit të performancës së zyrave të prokurorisë sic parashikohet në nenin 148/b shkronja “b”, “c” e “ç” të Kushtetutës. Në të njëjtën kohë, ky ndryshim siguron bashkëpunim dhe ndërveprim institucional midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe KLP për procesin e rëndësishëm të përzgjedhjes së kryetarit të zyrës së prokurorisë.

Ndryshimet në pikën 9 të këtij neni sigurojnë që kandidatët që kanë *masë disiplinore në fuqi* të përjashtohen nga kandidimi. Ky kriter i shtohet kriterëve ekzistues që parashikon ligji sipas të cilave përjashtohen kandidatët që nuk kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe figurës. Bashkë me shtesën që propozohet, ky nen garanton që në krye të zyrave të prokurorive apo gjykatave të zgjidhen magjistratë me integritet të lartë etik dhe profesional.

Shtimi i pikës 10/1 synon, që njësoj si në rastin e rizgjedhjes sipas pikës 4 më sipër, edhe në rastin e zgjedhjes për herë të parë për përzgjedhjen së kryetarit të prokurorisë, përveç vlerësimit të kritereve të renditura në pikën 10 shkronja a) deri c), konsiderohet edhe opinioni i Prokurorit të Përgjithshëm për kandidatin prokuror.

Në nenin 7 të projektligjit propozohet ndryshim në nenin 53 “*Parimet e komandimit të magistratëve*”, me synim incentivizimin e magistratëve për t’iu nënshtruar komandimit pranë zyrës së ILD. Projektligji parashikon që detyrimi për magistratët e komanduar për të shërbyer jo më pak se 5 vjet si magistratë pas përfundimit të komandimit, nuk aplikohet për magistratët e komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në projekt parashikohet se magistratët që janë komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk kanë një afat maksimal komandimi afatin 10 vjeçar, por 15 vjeçar. Këto propozime në kompleks i përgjigjen piketavë të ndërmjetme të BE.

Neni 8

Në nenin 8 të projektligjit reflektohen ndryshimet në nenin 53 pika 7 dh 8 të ligjit, të propozuara me këtë projektligj.

Në neni 9 të projektligjit, ndryshimet e propozuara në pikën 1 të nenit 55 “*Komandimi i magistratëve në Zyrën e Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*” synojnë parashikimin e kritereve të përvojës profesionale të spikatur për magistratët e komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ndryshimi në pikën 4 të nenit 55 ndërlidhet me afatin 7 vjeçar të komandimit dhe janë të ndërlidhura me ndryshimet e propozuara në nenin 53 pika 7 dhe 8, si dhe nenet 54 dhe 55.

Ndryshimet e propozuara synojnë të rrisin pëlqimin për komandimin si magistrat pranë ILD-së, kjo nëpërmjet garancive ligjore shtesë që pasojnë periudhën e komandimit. Kështu, ndryshimet në pikën 6 parashikojnë se përvoja si inspektor i komanduar konsiderohet vlerë e shtuar dhe do të ketë përparësi në vlerësimin dhe renditjen në lëvizjet paralele apo ngritjen në detyrë sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në nenin 10 të projektligjit propozohen ndryshimet në pikën 9 të nenit 95, “*Vendimi për vlerësimin*”, të cilat janë në të njëjtën linjë me ato që propozohen në nenin 190, pika 2 të Ligjit nr.115/2016.

Ato adresojnë shqetësime të Këshillave, mediave dhe shoqërisë civile në lidhje me mënyrën e publikimit të anonimizuar të vendimeve të Këshillave që lidhen me vlerësimin profesional. Parashikimi ekzistues e bënte vendimmarrjen jo transparente dhe shkonte përtej parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe zbatohet në disa raste në mënyrë jo uniforme nga të dy Këshillat. Për rrjedhojë, në rastet kur zbatohet detyrimi për anonimizim,

njoftimi për publikun kishte një përmbajtje të pakuptueshme për publikun që nuk i shërbente transparencës në lidhje me aspekte të statusit të magjistratit. Formulimi i propozuar krijon bazën ligjore për transparencë dhe është në linjë me parashikimet ligjore të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale duke garantuar redaktimin e të dhënave sensitive. Gjithashtu, garantohet mbrojtja e të dhënave personale për personat e tretë që nuk janë subjekte të ligjit, por që mund të përmenden në aktet e Këshillave.

Në neni 11 të projektligjit janë parashikuar ndryshimet në nenin 149, pika 2, “*Publikimi i vendimeve disiplinore*”, të cilat janë në linjë me ndryshimet në nenin 95, pika 9 të këtij ligji si dhe nenit 190, pika 2 të Ligjit nr.115/2016. Formulimi i propozuar krijon bazën ligjore për transparencë dhe është në linjë me parashikimet ligjore të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale duke garantuar redaktimin e të dhënave sensitive. Gjithashtu, garantohet mbrojtja e të dhënave personale për personat e tretë që nuk janë subjekte të ligjit, por që mund të përmenden në aktet e Këshillave.

Në neni 12 të projektligjit propozohet një dispozitë e re , neni 173/3 ‘*Dispozita tranzitore për caktimin e kryetarëve*’, si një dispozitë kalimtare, e cila parashikon që kryetarët aktualë apo drejtuesit aktualë të prokurorive do të qëndrojnë në detyrë deri në datë 31.12.2028 duke përmbushur disa kushte të tilla si kalimi i procesit të rivlerësimit kalimtar si dhe të kenë përmbushur detyrat lidhur me administrimin e instiucionit, brenda një kohe të arsyeshme dhe në mënyrë të kënaqshme sipas vendimit të Këshillit të Lartë gyqësor për kryetarët e gjykatave dhe vendim të Prokurorit të Përgjithshëm për drejtuesit e prokurorive.

Në nenin 13 të projektligjit parashikohet hyrja në fuqi e projektligjit 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.